



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	30.11.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	5710/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr. 863/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.863/2021 të datës 13.10.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Rr. "Abdullah Tahiri", Hyrja 3/14, Gjilan, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 26.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.863/2021 e datës 13.10.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Ndryshohet Vendimi me numër Ref.AUV/45/2021 i datës 20.09.2021 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, lidhur me masën disiplinore të shqiptuar ndaj ankuesit, ashtu që masa disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen e shkallës së pagës për periudhën tri (3) vjeçare", zëvendësohet me masën disiplinore "Vërejtje".
- III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, në pozitën e Udhëheqësit të Zyrës Regjionale në Gjilan, me datë 13.10.2021 ka parashtruar ankesë në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Vendimit me numër Ref.AUV/45/2021 të datës 20.09.2021 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen e shkallës së pagës për periudhën tri (3) vjeçare".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 18.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa, Këshilli më datë 28.10.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë, se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 863/2021, e datës 13.10.2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit të datës 19.08.2021 për pushim vjetor; me numër Ref.AUV/45/2021 të datës 20.09.2021 i Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë; Procesverbalin me nr. prot.5580 të datës 01.09.2021 të Komisionit Disiplinor, dëshmi për anulim e dasmës nga faqe 12-17; Kërkesën me numër protokollit 5518 e datës 29.08.2021, për fillimin e procedurës disiplinore; Vendimin me numër ref. AUv, 01-408/2021 i datës 31.08.2021, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, Vendimin Nr.01/27 të datës 18.08.2021 të Qeverisë së Kosovës, Vendimin me numër protokollit 5536 i datës 30.08.2021, për themelimin e Komisionit Disiplinor; e-mailin e datës 31.08.2021; Përgjigjen në ankesë të datës 28.10.2021, me numër protokollit 5199/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se është pjesërisht e bazuar ankesa e ankuesit
sepse:

Me datë 29.08.2021, zëvendësues i Drejtoreshës së Inspektoratit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (me tej AUV), ka parashtruar kërkesë pranë Komisionit Disiplinor të AUV-it për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit me pretendimin se ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore për shkak se i njëjti me organizimin e dasmës së djalit me datë 28.08.2021 ka shkelur dispozita e Ligjit nr.07/L-006 për parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19, Ligjit Nr.04/L-125 për Shëndetësinë dhe Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/27 të datës 1.08.2021 dhe me këtë veprim ka dëmtuar rëndë rendin publik dhe besimin e qytetarëve në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se procedura disiplinore është iniciuar pas Lajmit të publikuar me datë 28.08.2021 nga portali kallxo.com me titull " Masat e qeverisë Kurti nuk vlejné, inspektori i AUV marton djalin me 40 dasmorë". Shkrime me tej vijonte se:" Është njeriu kryesor në rajonin e Gjilanit i cili do të duhej kujdeset që ligji për parandalimin e pandemisë dhe vendimet e ekzekutivit kosovar të zbatohen në përpikëri. Por, Koordinator i Zyrës Regjionale nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) më Gjilan vendosi që të shtunën mbrëma të bëjë një mbledhi familjare..."

Komisioni Disiplinor i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore dhe dëgjimit të ankuesit, ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij gjegjësisht me organizmin e ahengut familjar në oborrin e tij në mbrëmjen e datës 28.08.2021, nuk ka zbatuar masat Anti Covid të cilat janë të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Kosovës Nr.01/27 të datës 18.08.2021 dhe si pasojë e kësaj ka dëmtuar besimin dhe imazhin e Agjencisë e Ushqimit dhe Veterinarisë, duke kryer shkelje të rëndë disiplinore dhe si rrjedhojë Komisioni Disiplinor bazuar në nenin 47 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 dhe 8 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përmes Vendimit me numër Ref.AUV/45/2021 të datës 20.09.2021, ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën tri (3) vjeçare".

Kundër këtij vendimi ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në KPMSHCK, me pretendimet se janë bërë shkelje procedurale ashtu qe kërkesa për inicim të procedurës disiplinore është bërë nga i cili ka qenë duke e zëvendësuar Drejtoren e Inspektoratit zn. dhe se Komisioni Disiplinor nuk ka ofruar asnjë fakt për shkelje të pretenduara.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe si rrjedhojë lidhur me përgjegjësinë disiplinore Kolegji ju referua nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se: "përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit. Ndërsa lidhur me kompetencën e organit për inicimin e procedurës disiplinore Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 48 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku është përcaktuar se: "Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.1. me kërkesë të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të nëpunësit civil; 4..... ka konstatuar se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë nga organi kompetent gjegjësisht nga zyrtari i cili ka zëvendësuar Drejtoren e Inspektoratit si Mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e ankuesit, e mbi këtë konstatim rrjedh së është i pa bazuar pretendimi ankimor i ankuesit.

Po ashtu me qëllim të vendosjes meritore, Kolegji ka analizuar Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/27 të datës 18.08.2021 për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19, sipas të cilit vendim në pikën F16 përcaktohej se nga data 20.08.2021 deri me datë 01.09.2021, ndalohet veprimtaria e klubeve të natës, dasmave, fejesave, ahengjeve familjare dhe mbrëmjeve të maturës, në gjithë territorin e Republikës së Kosovë, ndërsa bazuar në pikën M 46 të këtij vendimi, përgjegjës për të mbikëqyrë zbatimin e masave janë evidentuar Ministria e Shëndetësisë, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë si dhe Policia e Kosovës.

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe baza juridike si me lart, Kolegji vlerëson së mos respektimi i masave anti COVID nga ankuesi respektivisht organizmi i ahengut familjar në periudhën kur

organizimet e tilla kanë qenë tërësisht të ndaluara me vendimin e Qeverisë, nuk konsiderohen veprime të lidhura me detyrat dhe përgjegjësitë e punës së ankuesi, dhe se trajtimi i këtyre veprimeve bie në përgjegjësinë e organeve tjera kompetente, mirëpo, nisur nga fakti se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ka qenë një nga institucionet përgjegjëse për mbikëqyrje të zbatimit të masave anti covid si dhe duke marrë për bazë ndikimin publik të shkrimit medial lidhur me mos respektimin e masave kundër COVID nga ankuesi si zyrtar i lart i AUV-it, Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor ka cilësuar drejtë veprimet e ankuesit si veprime që kanë ndikuar në imazhin e institucionit, rrjedhimisht Kolegji duke u bazuar në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë më të cilin është përcaktuar se: *Shkelje të lehta konsiderohen:..4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar*” ka konstatuar se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë përgjegjësinë e ankuesit, por nuk ka bërë cilësimin e drejtë të shkeljes disiplinore dhe kështu ka zbatuar gabimisht dispozitat materiale lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit.

Bazuar në konstatimin se ankuesi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave sipas autorizimit ligjor të përcaktuar me nenin 18 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në kuptim të nenit 50 paragrafi 2 dhe 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin përcaktohet se “ 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer.... 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji..” ndryshon masën disiplinore për ankuesin nga masa disiplinore “Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë rritjen në shkallën e pagës për periudhën tri (3) vjet, me masën disiplinore “Vërejtje” e paraparë me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku e njëjta masë duhet të vendoset në dosjen personale të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave rikujton se ankesa me numër A.nr. 863/2021 e datës 13.10.2021, është trajtuar vetëm në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me disiplinën e nëpunësve civil, dhe së me rastin e vendosjes se të njëjtës nuk ka trajtuar çështjen lidhur me zbatimin dhe respektimin e masave anti covid, duke vlerësuar së trajtimi i tyre nuk është kompetencë e KPMSHCK-së.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda Nr. A. Nr. 863/2021

Rushit KAJTAZI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së